



## KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

### KOMUNIKATË PËR SHTYP

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, si institucioni ombrellë i sportit shqiptar dhe garant i parimeve olimpike në Republikën e Shqipërisë, ka detyrë ligjore dhe institucionale të mbrojtë, mbështesë, inkurajojë dhe promovojë të gjithë anëtarët e tij, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, Kartën Olimpikë dhe standardet ndërkombëtare të organizimit sportiv.

Në këtë kuadër, KOKSH respekton të drejtën e çdo organizate për të ushtruar aktivitetin e saj, por njëkohësisht ka detyrimin të garantojë zbatimin korrekt të ligjit dhe njohjen e strukturave zyrtare sportive, të cilat kanë të drejtën ekskluzive për organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe përfaqësimin ndërkombëtar.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe institucionet shtetërore njohin Federatën Shqiptare të Kolombofilëve, anëtare me të drejta të plota në KOKSH dhe e njohur ndërkombëtarisht, si të vetmin autoritet zyrtar për organizimin e aktiviteteve sportive kombëtare dhe përfaqësimin e Shqipërisë në aktivitetet ndërkombëtare të kësaj disipline.

Sa u përket pretendimeve të bëra nga shoqata “Pëllumbat e Postës 2003”, KOKSH shpreh respekt për aktivitetin dhe kontributin e saj në fushën e rritjes dhe mbarështimit të pëllumbave, por sqaron se licencimi që kjo shoqatë disponon lidhet me aktivitetin e rritjes dhe tregtimit për qëllime gare dhe nuk i njeh asaj të drejtën për organizimin e garave sportive zyrtare.

Çdo përpjekje për të keqinterpretuar kuadrin ligjor, për të deformuar rolin e institucioneve sportive apo për të krijuar konfuzion në opinionin publik përbën një qasje të papranueshme dhe keqdashëse, që synon dizinformimin për interesa të caktuara.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar do të vijojë të mbështesë zhvillimin e çdo disipline sportive në vend, duke garantuar respektimin e ligjit, autonominë sportive dhe parimet themelore të lëvizjes olimpike.